



# VIKTIMA TË TREGTISË ME QENIE NJERËZORE E DREJTA E NDIHMËS JURIDIKE DHE DËMSHPËRBLIMIT

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



Implemented  
by the Council of Europe



## NDIHMË JURIDIKE FALAS

Tregtia me qenie njerëzore është mjaft e njohur si një vepër penale serioze dhe shkelje e të drejtave të njeriut dhe si e tillë është përcaktuar në të drejtën vendore dhe ndërkombëtare. Tregtia me qenie njerëzore është forma e skllavërisë bashkëkohore. Një vepër penale bëhet kur tregtari me qenie njerëzore përdor, për shembull, dhunë, mashtrim ose detyrim për kontroll të ndonjë personi tjetër me qëllim, për shembull, të përfshirjes së tij/saj në aktivitete seksuale për përfitim ose për punësim, ose për dhënie të shërbimit. Tregtia me qenie njerëzore mund të përfshijë, por jo detyrimisht, transferim në ndonjë lokacion tjetër. Personat mund të konsiderohet si viktimë e tregtisë me qenie njerëzore pa marrë parasysh nëse janë të eksploator në qytetin e tyre të banimit, nëse janë të transportuar për qëllim të eksploatimit, nëse paraprakisht kanë rënë dakord të punojnë për tregtar me qenie njerëzore, nëse kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale si pasojë e drejtpërdrejte e tregtimit me ata, ose nëse është bërë eksploatimi i tyre. Një fëmijë do të konsiderohet si viktimë e tregtisë me qenie njerëzore pa marrë parasysh se cilat mënyra nga të përmendurat (dhuna, mashtrimi, keqpërdorimi i pozitës së cenuar, etj.) janë përdorur për të rekrutuar fëmijën me qëllim të eksploatimit.

*“Ana ishte mashtruar në zinxhirin e tregtisë me qenie njerëzore me një premtim të rrejshëm për punë në restorant. Ajo ishte shfrytëzuar në mënyrë seksuale për një vit pa mundësi të ikë nga tregtarët me qenie njerëzore. Ana ishte shpëtuar në një bastisje të policisë. Ajo ishte kyçur në programin për ndihmë sociale, e strehuar në vend të sigurt dhe i ishte dhënë mbështetje psiko-sociale dhe mjekësore. Ana ka marrë pjesë në procedurën gjyqësore si një palë e dëmtuar/dëshmitarë. I ishte siguruar ndihmë juridike falas nga avokati që e ka përfaqësuar në gjyq dhe ka kërkuar kompensim për vuajtjet e saja. Në fund të procedurës gjyqësore tregtarët me qenie njerëzore ishin të dënuar, dhe kërkesa e Anës për dëmshpërbim në shumë prej 6.500 euro ishte aprovuar nga gjykata”.*

## SI VIKTIMË E TREGTISË ME QENIE NJERËZORE JU TAKOJNË TË DREJTAT NË VIJIM:

- qasje në ndihmë juridike falas si viktimë, palë e dëmtuar ose dëshmitarë;
- mbrojtje dhe informacione nga policia, prokuroria dhe organet gjyqësore për të drejtat dhe obligimet tuaja, të dhënë në formë me shkrim;
- informacione për të drejtat tuaja në procedurë gjyqësore;
- të drejtë për periudhë të marrjes së vendimit;
- të drejtë për kërkim të dëmshpërblimit për lëndimet e pësuar;
- të drejtë për kujdestar nëse jeni fëmijë-viktimë;
- të drejtë për përkthyes nëse jeni shtetas i huaj dhe nuk e kuptoni gjuhën;
- të drejtë të lejes për qëndrim të përkohshëm;
- të drejtë për të kërkuar azil;
- të drejtë për privatësi dhe siguri;
- të drejta tjera të synuara për sigurim të mirëqenies suaj mendore dhe fizike.

## NDIHMË JURIDIKE FALAS

- Jeni të kyçur në programe për mbrojtje të viktimitave të tregtisë me qenie njerëzore të cilat zbatohen nga OJQ-të, për të cilën duhet të drejtoheni në polici, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale – Mekanizmin Kombëtar për Referim (MKR), Qendrën për Punë Sociale ose në OJQ Otvorena Porta.
- Kërkoni ndihmë juridike falas nëpërmjet departamenteve rajonale të Ministrisë së Drejtësisë ose shoqatave të autorizuara të qytetarëve (shikoni në fund të broshurës), me anë të të cilave do t'ju përcaktohet avokat.
- Avokati do të sqarojë procedurën për mbrojtje të të drejtave tuaja. Avokati duhet të dëgjojë historinë tuaj në detaje sepse ai/ajo do t'ju përfaqësojë para autoriteteve kompetente, do t'ju informojë për rrjedhën e procedurës dhe do të mbrojë interesat tuaja.

## DËMSPËRBLIMI

Viktimitat e tregtisë me qenie njerëzore janë të ekspozuar në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Përveç traumës së rëndë fizike dhe psikologjike,

mund të pësoni edhe humbje ekonomike për shkak të veprave penale që janë bërë mbi ju në formë të humbjes së rrogave ose të pronës. Si viktimë e tregtisë me qenie njerëzore **ju keni të drejtë të kërkonti dëmshpërblim ligjor nga kryerësit e veprës penale të dëmit material dhe jo-material.**

- **Dëmi material** – I përfshin të gjitha shpenzimet për mbrojtje shëndetësore, kontrolle dhe analiza, transport, dëmtime të pronës suaj dhe fitimit të humbur (nëse nuk keni qenë të fitoni ose nëse humbni të ardhura nga ndonjë aktivitet tjetër).
- **Dëmi jo-material** – Përfshin dhimbjen e pësuar fizike dhe mendore, frikën, invaliditetet serioz, aftësi për punë (dëm i ardhshëm jo-material).

## NË PROCEDURË PENALE DHE QYTETARE:

### PROCEDURË PENALE KUNDËR KRYERËSVE TË TREGTISË ME QENIE NJERËZORE

Procedura shërben për të mbledhur dëshmi të fortë për ndjekje penale dhe për ndëshkim të kryerësve të veprës penale tregti me qenie njerëzore. Keni të drejtë vetë ose nëpërmjet avokatit të:

- Kërkonti ndërmarrjen e aktiviteteve përkatëse gjatë hetimit ose gjykimit për të realizuar të drejtat tuaja;
- Të jeni të pranishëm gjatë gjykimit, të propozoni dëshmi, të rrëfeni historinë tuaj dhe të kërkonti dëmshpërblim ;
- Të kërkonti që të jeni të mbrojtur nga opinioni, mediet dhe nga kryerësit. Keni të drejtë të privatësisë dhe sigurisë si viktimë e tregtisë me qenie njerëzore.

## NËSE JENI FËMIJË-VIKTIMË (NËN MOSHËN 18 VJEÇ):

- Do të kyçeni në program për mbrojtje të dëshmitarëve pasi kujdestari juaj do të jep pëlqim me shkrim dhe do të merrni ndihmë juridike falas dhe mbrojtje;
- Policia do t'ju mbrojë juve dhe familjen nga vuajtjet e mëtutjeshme dhe shqetësimi;
- Organet kompetente duhet të veprojnë me ju me kujdes të veçantë dhe të mbrojnë privatësinë tuaj;

- Do të merrni ndihmën e nevojshme dhe mbështetjen nga Qendra për Punë Sociale dhe OJQ-të.
- Ju dhe prindërit/kujdestarët tuaj do të informoheni për ndjekjen penale dhe për procedurën dhe do të mund të merrni pjesë si palë e dëmtuar ose të realizoni të drejtën tuaj për dëmshpërblim të dëmit.

## PROCEDURA GJYQËSORE

Padia për dëmtim material dhe jo-material mund të dorëzohet personalisht ose me anë të personit të autorizuar. Në debatin kryesor, në të cilin keni të drejtë të merrni pjesë, gjykata do të merr vendim për t'ju dhënë dëmshpërblim, nëse kërkesa është mirë e sqaruar dhe mbështetur me dokumente dhe fakte. Nëse gjykata nuk jep dëmshpërblim dhe nëse shuma nuk është e mjaftueshme, keni të drejtë të ankoheni në Gjykatën e Apelit në afat prej 15 ditëve me anë të avokatit të autorizuar.

## PROCEDURA EKZEKUTUESE

Pasi të keni fituar aktgjykim të plotfuqishëm (penal ose civil) me shumën e dëmshpërblimit, mund të paguani shumën e përcaktuar.

- Nëse jeni në moshë mbi 18 vjeç, mundeni personalisht ose me përfaqësues ligjor, të angazhoni përmbarues që do të paguajë dëmshpërblimin e dhënë nga kryerësi/it.
- Nëse jeni në moshë nën 18 vjeç prindi, kujdestari juaj ose avokati i përcaktuar mund të nis procedurë para ekzekutuesit për të vlerësuar pronën e personit të gjykuar. Nëse kryerësi/it e veprës penale nuk kanë (mjaftueshëm) pronë ose mjete prej të cilëve mund të paguhet dëmi, kërkesa për konfirmim të bazave për dëmshpërblim parashtrohet në gjykatën kompetente. Pasi që gjykata të marrë vendim, ka mundësi që Ministria e Drejtësisë të aprovojë pagesën e dëmshpërblimit.

## PËR TË MBROJTUR TË DREJTAT TUAJA

Mund të paraqitni edhe kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse i keni harxhuar gjitha mënyrat tjera ligjore në kuadër të sistemit vendor ligjor.

## KONTAKT ME INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT RELEVANTE PËR DHËNIEN E NDIHMËS DHE MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E TREGTISË ME QENIE NJERËZORE:

- **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale – Mekanizmi Kombëtar për Referim,**  
telefon:023106443,  
celular:076456795,  
celular:075311726
- **Policia:192**
- **Shoqata për Veprim kundër Dhunës dhe Tregtisë me Qenie Njerëzore – Otvorena Porta**  
Linjë SOS falas  
080011111;022700107  
www.lastrada.org.mk;  
e-posta:lastrada@lastrada.org.mk
- **Avokati i Popullit,**  
rr. “Maqedonia” nr. 19  
telefon:02 3129335;023 129359;  
e-posta:contact@ombudsman.mk  
Internet faqe:  
<http://pristapodpravda.mk/bpp/>

## LISTË E ORGANIZATAVE TË AUTORIZUAR PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

- **Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj– Shkup**  
rr. “Zlatko Shnajder” nr.4a-1/3, Shkup,  
Person për kontakt: Elena Georgievska  
telefon:02/3220-870  
e-posta:contact@myla.org.mk;  
www.myla.org.mk
- **Qendra Kombëtare e Romëve - Kumanovë**  
rr.“Done Bozhinov” nr.11/5,Kumanovë  
Person për kontakt: Oliver Mitov, jurist i diplomuar  
telefon:031/427-558  
e-posta:info@nationalromacentrum.org  
Internet faqe:www.nationalromacentrum.org
- **Organizata Edukative Humanitare EHO – Shtip,**  
rr. “Hristijan T. Karposh” nr.6/4, Shtip  
Person për kontakt: Bllagica Kirov,  
juriste e diplomuar  
telefon:032/384-143  
e-posta:ed\_hum\_eho@yahoo.com  
Internet faqe:www.eho-org.mk

## PËR OTVORENA PORTA

*Shoqata për Veprim kundër Dhunës dhe Tregtisë me Qenie Njerëzore – Otvorena Porta/La Strada është organizatë kombëtare joqeveritare që është tërësisht dedikuar luftës kundër tregtisë me qenie njerëzore. Nga themelimi në vitin 2000, Otvorena Porta në mënyrë të hapur trajton problemin e tregtisë me qenie njerëzore dhe në mënyrë aktive merr pjesë në krijimin e politikave*

*dhe strategjive për të zvogëluar numrin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe sigurim të trajtimit më të mirë të viktimave. Otvorena Porta udhëheq me një strehimore në të cilën trajtohen viktimat e tregtisë me qenie njerëzore dhe ju jep shërbime viktimave për re-integrim të suksesshëm; ju jep informacione për problemin me tregtinë me qenie njerëzore dhe për mënyrat e parandalimit me anë të linjave SOS të telefonit që janë falas për ata që denoncojnë nga brenda shtetit.*

*Broshura nuk ka qëllim të këshillës juridike dhe nuk zëvendëson nevojën për kërkim të këshillës juridike.*

*Broshura është përpunuar me mjete të përbashkëta të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Në asnjë mënyra nuk mund të konsiderohet që shqyrtimet dhënë në këtë broshura pasqyrojnë mendimin e Këshillit të Evropës ose Bashkimit Evropian.*

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



Implemented  
by the Council of Europe

